



Në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, pika 1.1.1, nenit 12 paragrafi 1, nënparagrafi 1.5 dhe nenit 29 paragrafi 4 të Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, si dhe nenit 7 paragrafi 4 të Rregullores nr. 01/2018, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 01/2014 dhe Rregullores Nr. 01/2017 të Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, me datë 17.10.2022, nxjerrë këtë:

V E N D I M

- I. Mbyllet rasti AKK-DPKI-06-3477/22 , për zyrtarin e lartë z. Murat Kursani, zv. Shef i njësisë për buxhet dhe financa në Spitalin e Përgjithshëm “Isa Grezda” - Gjakovë, për shkak se është shmangur gjendja e papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit publik.**

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin e lartë z. Murat Kursani, është trajtuar sipas procedurës së paraparë me Ligjin nr. 06/L-011, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Ky rast ka filluar të trajtohet pasi është identifikuar se z. Murat Kursani, krahas ushtrimit të funksionit publik zv. Shef i njësisë për buxhet dhe financa në Spitalin e Përgjithshëm “Isa Grezda” - Gjakovë, është edhe përfaqësues i autorizuar në biznesin privat Zyra Shërbyese “Mk-Consulting”.

Agjencia, e ka njoftuar zyrtarin e lartë me shkresë zyrtare për fillimin e procedurës për shqyrtimin e gjendjes së konfliktit të interesit.

Zyrtari i lartë, gjatë ushtrimit të funksionit publik nuk mund të jetë përfaqësues i autorizuar në biznes privat, kjo për faktin se një situatë e tillë paraqet gjendje të papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit publik. Kjo ndalohet me dispozitën e nenit 13 paragrafi 1, të Ligjit nr.06/L-011 për parandalimin e konfliktit të interesit në të cilën shprehimisht thuhet se:

1. Zyrtari i lartë nuk mund të jetë menaxher, përfaqësues i autorizuar ose anëtar i ndonjë organi menaxhues apo mbikëqyrës i personave juridikë privatë, fitimprurës sipas ligjit përkatës për shoqëritë tregtare dhe organizatave joqeveritare, përjashtuar subjektet e përcaktuara në nenin 14 të këtij ligji, subjektet politike si dhe rastet kur një funksion i tillë i dedikohet me ligj për shkak të funksionit.

Lidhur me këtë rast, zyrtari i lartë është kontaktuar nga Agjencia lidhur me rastin, për të dhënë informacionet lidhur me gjendjen në të cilën ndodhet dhe për veprimet që duhet ti ndërmarr për të shmangur gjendjen e papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit publik. Gjatë bisedës së zhvilluar, zyrtari i lartë ka deklaruar se pas pranimit të shkresës nga Agjencia, është larguar nga funksioni i përfaqësuesit të autorizuar në biznes privat


Ndërkohë, zyrtari i lartë ka dërguar në Agjenci shkresën zyrtare nr.(06-01/3794-1/22) me të cilën dëshmohet se është larguar nga funksioni i përfaqësuesit të autorizuar në biznes privat

Pas analizimit të informatave të biznesit, Agjencia konstatoi se me veprimet që i ka ndërmarrë zyrtari i lartë, është shmangur gjendja e papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit publik.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në pikën I. të dispozitivit të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPKI- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)


Ylli Bulleshkaj
Drejtore i Agjencisë për
Parandalimin e Korrupsionit

